



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2022:112709  
Datë: 14.05.2024  
Numri i dokumentit: 05683205

**E.nr.721/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorëve: P.R., E.S., L.Z., R.I. dhe H.N., të cilët i përfaqëson av Urim Bajraktari nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria Komunale e Arsimit Ferizaj, për pagesën e ushqimit dhe udhëtimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 14.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.721/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.721/23, të datës 16.05.2023 e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Drejtoria Komunale e Arsimit në Ferizaj, për pagesën e udhëtimit dhe ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2022:112709, të dt.12.08.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 21.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,238.60 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorët.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.721/23, më datë 14.05.2023**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**